


Tregtia e jashtme e mallrave

Tetor 2025

Tiranë, më 17 Nëntor 2025: Në Tetor 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 31 mld lekë, duke u rritur me 1,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 14,5 %, në krahasim me Shtator 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 80 mld lekë, duke u rritur me 3,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 6,3 %, në krahasim me Shtator 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 49 mld lekë, duke u rritur me 5,4 %, krahasuar me Tetor 2024 dhe me 1,6 %, në krahasim me Shtator 2025.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dhjetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 291 mld lekë, duke u ulur me 7,0 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 737 mld lekë, duke u ulur me 0,8 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 445 mld lekë, duke u rritur me 3,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Tetor 2025, në rritjen e eksporteve prej 1,0 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,8 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,4 pikë përqindje. Negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,8 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -2,1 pikë përqindje, etj.

Për publikim 17/11/2025

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2025




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë ulur me 7,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -5,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -1,3 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,0 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Tetor 2025, në rritjen e importeve prej 3,6 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, en.el.” me +1,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” dhe “Tekstile dhe këpucë” me nga +0,9 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2025



Si dhjetëmujor, importet janë ulur me 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,0 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,8 dhe pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Tetor 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2024 janë: Greqia (10 %), SHBA (5 herë), Spanja (28,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (13,2 %), Kosova (2,7 %), Gjermania (0,9), etj.

Gjatë këtij dhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (11,1 %), Kosova (12,6 %) dhe Kina (0,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Greqia (6,7 %) Gjermania (4,9 %) dhe Spanja (27,6 %).

Në muajin Tetor 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Italia (6,1 %), Kina (31,2 %) dhe Greqia (4,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Turqia (20,3 %), Gjermania (2,4 %), SHBA (33,4 %) etj.

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (1,8 %), Turqia (14,9 %) dhe Gjermania (5,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (24,3 %), Greqia (4,0 %) dhe Spanja (10,9 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 57,4 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 69,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,5 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,8 %), Kina (11,0 %), Greqia (7,6 %) dhe Gjermania (6,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin 2025, me vendet e BE-së zënë 57,4 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,3 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,0 %), Kina (10,4 %), Greqia (7,7 %) dhe Turqia (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Tetor 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		367	35,0	784	29,6	-423	46,0
2022		481	30,9	950	21,2	-464	51,2
2023		430	-10,4	873	-8,2	-432	50,5
2024		369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2023	01 - 23	42	20,4	58	5,8	-16	71,9
	02 - 23	38	3,6	69	1,1	-32	54,4
	03 - 23	42	-9,7	81	-3,7	-39	51,8
	04 - 23	34	-19,6	75	-3,9	-41	45,1
	05 - 23	39	-11,9	81	1,2	-41	49,0
	06 - 23	37	-17,9	75	-7,5	-38	49,9
	07 - 23	35	-10,4	71	-13,6	-36	49,3
	08 - 23	24	-29,7	68	-15,0	-44	35,6
	09 - 23	33	-13,1	73	-16,6	-40	45,2
	10 - 23	36	-4,1	78	-6,3	-42	46,7
	11 - 23	33	-21,5	72	-7,4	-39	45,8
	12 - 23	37	-6,5	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj. 23	430	-10,4	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	29	-30,0	60	3,4	-31	48,7
	02 - 24	32	-16,0	74	6,4	-42	43,0
	03 - 24	33	-20,8	75	-7,0	-42	44,1
	04 - 24	34	2,2	75	0,6	-41	45,7
	05 - 24	35	-12,5	79	-1,6	-45	43,5
	06 - 24	34	-8,6	77	2,1	-42	44,7
	07 - 24	33	-6,1	85	21,1	-53	38,2
	08 - 24	22	-8,4	69	1,9	-47	32,0
	09 - 24	30	-8,2	71	-3,1	-41	42,9
	10 - 24	31	-15,4	77	-1,5	-46	40,1
	11 - 24	30	-8,3	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	25	-31,4	79	8,3	-53	32,2
	Jan-Dhj. 24	369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2025	01 - 25	28	-4,5	60	0,1	-32	46,4
	02 - 25	30	-5,3	68	-8,6	-37	44,6
	03 - 25	31	-4,9	74	-1,4	-42	42,5
	04 - 25	30	-13,3	76	0,5	-46	39,5
	05 - 25	32	-7,9	78	-2,1	-46	41,0
	06 - 25	31	-9,0	77	-0,2	-45	40,8
	07 - 25	30	-6,9	83	-2,4	-53	36,5
	08 - 25	20	-8,4	67	-2,7	-47	30,1
	09 - 25	27	-10,7	75	5,6	-48	36,3
	10 - 25	31	1,0	80	3,6	-49	39,1
	Jan-Tet. 25	291	-7,0	737	-0,8	-445	39,6

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Tetor 2025

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2024	Tetor 2025	Jan. – Tet. 2024	Jan. – Tet. 2025	Tetor 2024	Tetor 2025	Jan. – Tet. 2024	Jan. – Tet. 2025
Vendet e BE-së	23.385	21.727	223.395	212.360	41.591	41.850	383.447	377.847
Austri	283	155	2.088	1.434	567	517	6.582	5.770
Gjermani	1.942	1.925	18.350	19.258	5.865	5.725	53.276	50.133
Greqi	1.960	2.157	18.517	19.766	6.050	6.303	57.004	59.310
Itali	14.370	12.469	137.876	122.621	17.330	18.384	157.648	154.748
Spanjë	1.159	1.493	10.876	13.882	1.217	1.029	11.158	12.371
Kroaci	232	239	2.410	2.220	456	545	4.243	5.998
Të tjera të BE-së	3.438	3.289	33.279	33.179	10.107	9.347	93.535	89.516
Mbretëri e Bashkuar	157	93	1.261	946	748	586	8.009	7.141
Kinë	829	1.078	9.226	9.218	8.427	11.058	78.335	97.407
Kosovë	2.658	2.588	31.699	27.695	1.263	1.629	13.417	13.164
Maqedonia e Veriut	639	595	10.382	7.331	909	1.381	9.846	12.100
Rusi	-	-	7	6	474	269	3.335	3.271
SHBA	347	1.961	6.185	4.871	1.960	1.306	16.760	14.708
Turqi	567	315	3.506	4.314	8.344	6.646	81.998	69.799
Ukrainë	212	14	2.932	387	234	235	3.377	2.898
Zvicër	86	172	1.941	1.211	1.339	1.940	7.992	8.509
Të tjera	1.949	2.598	22.838	22.987	11.592	12.779	136.008	129.737
Gjithsej	30.831	31.141	313.373	291.327	76.881	79.680	742.526	736.583

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Tetor 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2024	Tetor 2025	Jan. – Tet. 2024	Jan. – Tet. 2025	Tetor 2024	Tetor 2025	Jan. – Tet. 2024	Jan. – Tet. 2025
Gjithsej	30.831	31.141	313.373	291.327	76.881	79.680	742.525	736.583
Ushqime. pije. duhan	4.475	4.689	43.016	46.092	13.547	13.633	130.613	135.095
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	5.644	4.767	57.923	53.734	7.850	9.335	76.946	83.047
Produkte kimike dhe plastike	1.277	1.194	13.041	10.881	10.234	10.894	96.353	98.218
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	186	139	1.696	1.550	1.015	1.080	9.811	9.322
Prodhime druri dhe letre	912	840	8.357	8.256	2.555	2.591	24.814	24.567
Tekstile dhe këpucë	9.504	8.845	88.473	87.580	8.194	8.864	72.209	71.893
Materiale ndërtimi dhe metale	4.473	5.959	58.380	41.141	9.581	8.924	101.887	94.548
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	3.349	3.777	31.499	33.302	19.946	20.480	196.134	186.910
Të tjera	1.011	931	10.989	8.791	3.960	3.879	33.758	32.981

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Tetor 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	137.876	122.621	31.699	27.695	18.517	19.766	18.350	19.258
Ushqim, pije duhan	11.643	9.781	5.186	5.920	3.570	4.041	1.601	1.597
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	11.198	3.525	7.589	12.316	1.577	1.024	5.064	3.910
Produkte kimike dhe plastike	4.779	3.648	3.495	2.482	794	711	59	50
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.469	1.272	6	15	148	154	1	2
Prodhime druri dhe letre	4.359	4.320	1.035	953	1.310	1.261	109	110
Tekstile dhe këpucë	66.377	63.209	140	127	6.700	8.005	7.612	8.690
Materiale ndërtimi dhe metale	17.943	16.802	11.439	2.693	3.566	3.560	883	747
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	15.731	15.600	1.684	2.272	198	211	2.655	3.731
Të tjera	4.377	4.464	1.126	917	655	800	366	421

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Tetor 2025

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	157.648	154.748	78.335	97.407	81.998	69.799	57.004	59.310
Ushqim, pije duhan	26.776	29.178	1.447	1.769	4.549	4.320	15.907	17.536
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.753	7.359	17	13	9.309	6.899	9.671	9.017
Produkte kimike dhe plastike	19.339	19.146	6.459	7.274	10.206	9.742	9.295	10.186
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.526	7.054	840	832	301	351	131	127
Prodhime druri dhe letre	5.058	5.166	1.742	2.155	3.904	3.865	3.348	3.526
Tekstile dhe këpucë	30.030	28.805	11.957	13.186	10.007	8.390	5.237	6.003
Materiale ndërtimi dhe metale	18.325	17.061	10.421	16.489	24.770	22.575	7.753	6.748
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	37.008	32.580	38.485	47.575	15.401	9.928	3.691	4.269
Të tjera	9.833	8.400	6.967	8.114	3.550	3.730	1.969	1.898

Metodologjia

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<https://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri